

VENDIM
Nr. 594, datë 1.7.2015

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SËMUNDJEVE PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së sëmundjeve profesionale, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr. 396, datë 28.6.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 shtator 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I
LISTA
E SËMUNDJEVE PROFESIONALE

Sëmundjet e përmendura në këtë listë konsiderohen sëmundje profesionale kur lidhen direkt me profesionin e pacientit dhe ekspozimin në vendin e punës.

1	Sëmundjet e shkaktuara nga agjentët e mëposhtëm kimikë:
	Akrilonitril
	Arsenik ose përbërës të tij
	Berilium (glucinium) ose përbërës të tij
	Monoksid karboni
	Oksiklorid karboni
	Acid hidrociyanik
	Cianide dhe përbërës të tyre
	Izocianate
	Kadmium ose përbërës të tij
	Krom ose përbërës të tij
	Mërkuri ose përbërës të tij
	Mangan ose përbërës të tij
	Acid nitrik
	Okside të azotit
	Amoniak
	Nikel ose përbërës të tij
	Fosfor ose përbërës të tij
	Plumb ose përbërës të tij
	Okside të sulfurit
	Acid sulfurik
	Disulfid karboni
	Vanadium ose përbërës të tij
	Klor brom

	Jod
	Fluor ose përbërës të tij
	Hidrokarbure aliciklike ose alifatike të përfutur nga esenca e naftës ose nafta
	Derivate të halogjenizuara të hidrokarbureve alfatike ose aliciklike
	Butil, metil dhe alkool izopropil
	Glikol etileni, glikol dietileni, 1,4-butanediol dhe derivate azotikë të glikoleve dhe glicerolit
	Eter metili, eter etili, eter izopropili, eter vinili, eter dikloroizopropili, guaiakol, eter metili dhe eter etili i glikolit të etilenit
	Aceton, kloroaceton, bromoaceton, hegzafluoroaceton, keton etil metili, keton n-butil metili
	Keton izobutil metili, alkool diacetoni, oksid mesitili, 2-metilciklohexanon
	Estere organofosforike
	Acide organike formaldehyde
	Derivate azotikë alifatikë
	Benzen ose homologë të tij (homologët e benzenit përcaktohen nga formula: C_nH_{2n-6})
	Naftalinë ose homologë të naftalinës (homologët e naftalinës përcaktohen nga formula: C_nH_{2n-12})
	Vinilbenzen dhe divinilbenzen
	Derivate të halogjenizuar të hidrokarbureve aromatike
	Fenol ose homologë apo derivate të halogjenizuar të tyre
	Naftole ose homologë apo derivate të halogjenizuar të tyre
	Derivate të halogjenizuar të oksideve të alkilarilit
	Derivate të halogjenizuar të sulfonateve të alkilarilit
	Benzokuinone
	Amina aromatike apo hidrazinat aromatike apo derivate të halogjenizuar, fenolike, nitrati apo sulfati të tyre
	Amina alfatike dhe derivate të halogjenizuar të tyre
	Derivate nitrati të hidrokarbureve aromatike
	Derivate nitrati të fenolëve ose homologëve të tyre
	Antimon dhe derivate të tij
	Estere të acidit nitrik

	Sulfit hidrogjeni
	Encefalopati për shkak të tretësve organikë që nuk vijnë nën rubrika të tjera
	Polineuropati për shkak të tretësve organikë që nuk vijnë nën rubrika të tjera
2	Sëmundjet e lëkurës, të shkaktuara nga substancat dhe agjentët e papërfshirë në rubrikat e tjera:
	Sëmundjet e lëkurës dhe tumoret e lëkurës të shkaktuara nga:
	Bloza
	Zifiti
	Bitumi
	Katrani
	Antraceni ose përbërës të tij
	Vajrat minerale dhe vajrat e tjera
	Parafina bruto
	Karbazoli ose përbërës të tij
	Nënproduktet e distilimit të qymyrit
	Sëmundjet profesionale të lëkurës të shkaktuara nga alergji të njohura shkencërisht - substanca provokuese ose irrituese të papërfshira në rubrikat e tjera
3	Sëmundjet e shkaktuara nga inhalacioni i substancave dhe agjentëve të papërfshirë në rubrikat e tjera:
	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes dhe tumoret:
	Silikoza
	Silikoza e kombinuar me tuberkulozin pulmonar
	Asbestoza
	Mezotelioma e ndjekur nga inhalacioni i pluhurit të asbestit
	Pneumokonioza e shkaktuar nga pluhurat e silikateve
	Komplikimet e asbestit në formën e tumorit bronkial
	Sëmundjet bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat e metaleve të shkrira
	Alveolitet alergjike ekstrinseke
	Sëmundjet e mushkërive të shkaktuara nga inhalacioni i pluhurave dhe fibrave të pambukut, linit, kërpit, juta, sizali dhe gëzhuta

	Sëmundjet respiratore të shkaktuara nga inhalacioni i pluhurit të kobaltit, kallajit, bariumit dhe grafitit
	Sideroza
	Sëmundjet kancerogjene të rrugëve të sipërme respiratore të shkaktuara nga pluhuri i drurit
	Astma alergjike të shkaktuara nga inhalacioni i substancave të njohura vazhdimisht si shkaktare të alergjive dhe që lidhen me llojin e punës
	Rinititi alergjik i shkaktuar nga inhalacioni i substancave të njohura vazhdimisht si shkaktare të alergjive dhe që lidhen me llojin e punës
	Sëmundje fibrotike të pleurës, me kufizim të frymëmarrjes shkaktuar nga asbesti
	Bronshiti apo emfizema obstruktive kronike të minatorët që punojnë në minierat e nëndheshme të qymyrit
	Kanceri i mushkërisë mbas inhalacionit të pluhurit të asbestit
	Sëmundje bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat ose gazrat nga alumini ose përbërës të tij
	Sëmundje bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat
4	Sëmundjet infektive dhe parazitare:
	Sëmundjet infektive dhe parazitare që u transmetohen njerëzve nëpërmjet kafshëve apo mbetjeve të kafshëve:
	Tetanozi
	Bruceloza
	Hepatiti viral
	Tuberkulozi
	Amebiazi
	Sëmundje të tjera infektive të shkaktuara nga puna në parandalimin e sëmundjeve, qendrat shëndetësore, asistencë në shtëpi dhe aktivitete të tjera të ngjashme, për të cilat është provuar një rrezik infektimi
5	Sëmundjet e shkaktuara nga agjentët e mëposhtëm fizikë:
	Katarakte të shkaktuara nga rrezatimi i nxehtësisë
	Sëmundjet konjuktivale që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit ultravjollcë
	Hipoakusis apo humbja e dëgjimit e shkaktuar nga zhurma
	Sëmundjet e shkaktuara nga kompresioni apo dekompresioni atmosferik
	Sëmundjet osteoartikulare të duarve dhe kyçeve të duarve të shkaktuara nga dridhja mekanike
	Sëmundjet angioneurotike të shkaktuara nga dridhja mekanike

	Sëmundje që manifestohen me edema të indeve periartikulare për shkak të presionit
	Bursit prepatelar dhe subpatelar
	Bursit olekranon
	Bursiti i shpatullave
	Sëmundje për shkak të lodhjes të këllëfëve të tendinave
	Sëmundje për shkak të lodhjes së peritendineumit
	Sëmundje për shkak të lodhjes së insertimeve muskulore dhe tendinoze
	Lezione të meniskut nga periudhat e zgjatura të punës në pozicion të gjunjëzuar ose në bisht
	Paralizë e nervave për shkak të presionit
	Sindroma e tunelit karpal
	Nistagmusi i minatorit
	Sëmundjet e shkaktuara nga rrezatimi jonizues